



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 17 Prot

Tiranë, më 04, 02, 2011

VENDIM Nr. 129, dt. 04.02.2011

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 47, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen e datës 04.02.2011, mbasi shqyrtoi "Raportin përfundimtar mbi sondazhet arkeologjike të kryer në sheshin e ndërtimit në pronësi të Familjes Profkola, Lagjja Nr. 5, Rruga "Andon Naçi", Durrës (Subjekti "LERENTI" sh.p.k) – Agjencia e Shërbimit Arkeologjik

**VENDOSI:**

- I. Miratimin e raportit përfundimtar të sondazhit arkeologjik, të paraqitur nga ASHA për sheshin e ndërtimit të subjektit "LERENTI" sh.p.k, në adresën Lagjja Nr.5, Rruga "Andon Naçi", Durrës.
- II. Të lejojë fillimin e punimeve në sheshin e ndërtimit "Godinë banimi dhe shërbimi 3-5 kate mbi tokë dhe 1 kat nën tokë", zona "B", Durrës, të subjektit "LERENTI" sh.p.k.
- III. Të realizohet mbikëqyrja arkeologjike gjatë procesit të gërmimit të themeleve, bazuar në kontratën dypalëshe midis "LERENTI" sh.p.k. dhe Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.
- IV. Mbikëqyrja arkeologjike do të kryhet nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik dhe Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Durrës deri në arritjen e kuotës së gërmimit të parashikuar në projekt.
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

FERDINAND XHAFERAJ

MINISTËR

SEKRETAR I KKA

ROLAND OLLI



AGJENCIA E  
SHËRBIMIT  
ARKEOLOGJIK

Adresa: Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve,  
Rruga e Kavajës, Tiranë, Tel/Fax: +355 4 2272171  
e-mail: sekretaria.teknike@asha.gov.al